



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-9167/24
Kaçanik, 17.04.2024

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa,

Në bazë të nenit 52.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e IV (katërt) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2024.

Mbledhja do të mbahet në katin e dytë të objektit të komunës, në sallën e komiteteve të kuvendit, me 25.04.2024 (e Enjte), më fillim pune në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Në mbledhjen e IV (katërt) të Rregullt të KPF-s të datës 25.04.2024, do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Raporti tremujor financiar për periudhën: Janar-Mars 2024;
3. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Bob, në emër të Elmaz Mezraja B.I. nga f. Kovaçec;
4. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Elezaj, në emër të Ndërmarrjes “Migros Group” me përfaqësues Mustafë Rexhepi, në Qirambajtje për 99 vite;
5. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Bob, në emër të “Dream Palace” SH.P.K. nga Ferizaj, me përfaqësues Avni Etemi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-6693/24
Kaçanik, 25.03.2024

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **III (tretë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 25 mars 2024 Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF ishin 7 anëtarë: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Fitore Vishi, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Ardita Rrahmani, Rabije Sallahi.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Nënkryetari i Komunës: Sabedin Vishi, Drejtorët e Drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Sali Malsiu, Suhad Dullovi, ndërkaq nga zyrtarët ishte Fatlume Guri-Selimi.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtës: Makfire Malsiu- ZLP për Punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, pjesëmarrës në këtë mbledhje janë 7 anëtarët- të gjithë. Kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, e hapi mbledhjen e III (tretë) të rregullt të KPF-a për vitin 2024, data 25 mars, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Draft Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare;
3. Propozim Vendimi për aktivizimin e pagesave në QKMF në Komunën e Kaçanikut;
4. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Ivajë, në emër të Samedin Rexha;
5. Propozim Vendim për shpallje me interes publik të Parcelave kadastrale në Zona Kadastrale Kaçanik dhe Gajre;
6. Propozim Vendim për Subvencionim të fermerëve;
7. Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, të vitit 2022;
8. Raporti i punës i Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2023.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtoj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 8 pikave.

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

z. Agim Mani: Unë kam vërejtje se nuk janë përfshirë në procesverbal të gjitha çështjet esenciale që kanë qenë shumë me rëndësi me u përfshirë, kështu që ne nuk do të marrim pjesë në votim të procesverbalit.

Kryesuesi i Kuvendit: Ku keni vërejtje Agim?

z. Agim Mani: Vërejtje kam shumë, ju e dini çka kam diskutuar dhe çka është shkruar. Unë iu kam drejtuar procesmbajtëses Mavijes, gjatë diskutimit për me shënuar atë që e tha Kryetari i Komunës, por nuk e ka shënuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne duhet me mbajtur një rend në mbledhje të KPF, për me qenë me lehtë mbajtja e procesverbalit, se nganjëherë çështjet po kalojnë në bashkëbisedim.

Procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KPF e shtoj në votim për aprovim: Rezultati i votimit, 5 anëtarë ishin Për, Kundër votë nuk ka, Abstenim votë nuk ka, ndërkaq nuk votuan: Agim Mani dhe Kadrije Lika-Troni. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së II (dytë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për vitin 2023 të datës 23.02.2024 / Lënda: 01Nr. 60/01-4361/24

2. Draft Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori është prezentë, para se hapur diskutimin fjalën e ka drejtori Sali Malsiu.

z. Sali Malsiu: Ministria e Shëndetësisë në bazë të Ligjit Nr.04/L-125 për Shëndetësi dhe Udhëzimit Administrativ 04/2020, ka hartuar një Draft Statut i cili është i njëjtë për të gjitha komunat. Statuti i QKMF e ka një rëndësi të madhe për funksionalizimin dhe organizimin e QKMF. Ne e kemi formuar Grupin punues për hartimin e këtij draft statuti, i cili ka bërë disa ndërhyrje të vogla, se nuk kemi kompetencë me ndërhyrë shumë, sepse statuti është unik për të gjitha komunat. Drafti ka qenë në konsultim publik në faqen e komunës, është mbajtur debati publik, kemi marrë edhe Pëlqimin nga MSHMS, d.m.th. draft statuti i ka kaluar të gjitha procedurat e parapara me ligj.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Kam një pyetje për çështjen e financave: A përfshihet në këtë Statut pagesa e pacientëve?

z. Sali Malsiu: Përfshihet të pika 2, edhe në statutin tjetër ka qenë i paraparë, edhe në këtë draft parashihet.

Kryesuesi i Kuvendit: Çështja e pagesave parashihet me Rregulloren e taksave komunale.

znj. Fitore Vishi: Drejtor, A mendoni se është e mjaftueshme mbulimi i shërbimeve shëndetësore me 1 mjek familjarë dhe 2 infermiere në 2000 banorë?

z. Sali Malsiu: Kjo është e rregulluar me Udhëzim administrativ në krejt tërë territorin e Kosovës, nuk e vendosim ne si komunë. Neve na nevojiten me tepër shërbime shëndetësore, por kjo është e përcaktuar me Udhëzim administrativ.

Kryesuesi i Kuvendit: Për me i mbuluar shërbimet shëndetësore, ne duhet me i pasur 15 mjekë se paku, por nuk i kemi. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjta aprovohet njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e

Aprovoj

Draft Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare. Ky Draft Statut i Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

3. Propozim Vendimi për aktivizimin e pagesave në QKMF në Komunën e Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit: Gjatë kohës së pandemisë, KK ka marrë një vendim për lirim nga pagesa të shërbimeve shëndetësore. Besoj se tani janë plotësuar kushtet për aktivizimin e shërbimeve shëndetësore, edhe me herët janë plotësuar kushtet, se pandemia ka përfunduar zyrtarisht. Pagesat bëhen sipas Rregullores për taksat komunale që është në fuqi. Fjalën e ka drejtori i DSHMS, Sali Malsiu.

z. Sali Malsiu: Lidhur me Vendimin për aktivizimin e pagesave të shërbimeve shëndetësore në QKMF, të pika 4, ku thuhet me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet pika 2 e Vendimit 01Nr. 60/01-9754/20 për lirim nga qiraja komunale për shfrytëzuesit e pronës komunale për vitin 2020 si dhe lirimi nga pagesa e shërbimeve shëndetësore deri në përfundim të pandemisë Covid-19 i datës 27.06.2020. Të pjesa e lirimit nga qiraja komunale, vendimi është shfuqizuar menjëherë pas një viti, por titulli i vendimit është i tillë, se vendimi ka qenë i përgjithshëm. Tani kemi të bëjmë me shfuqizimin e pikës 2, të vendimit, që ka të bëjë me lirimin nga pagesa e shërbimeve shëndetësore deri në përfundim të pandemisë.

znj. Kadrije Lika Troni: Të qiraja komunale, për cilat është fjala, se nuk po e kuptoj?

Kryesuesi i Kuvendit: Ka të bëjë me lirimin e personave nga qiraja për objektet apo pronat e komunës që i kanë pasur në shfrytëzim. Në vitin 2020 janë liruar nga qiraja për 1 vit, se ka qenë vit pandemie. Atë pikë e kemi shfuqizuar me një vendim me herët, vendimi ka qenë i përbashkët, tani po e shfuqizojmë pikën 2 të vendimit, se titulli i vendimit ka qenë i tillë.

z. Kadri Krivenjeva: Sa është kontrolla mjekësore, për 1 person?

Kryesuesi i Kuvendit: Është e rregulluar me rregulloren e taksave komunale, është 1€, ka edhe shërbime tjera, janë të potencuar në rregullore.

z. Sali Malsiu: Të gjitha shërbimet shëndetësore, pagesat janë në rregulloren e taksave komunale. Me këtë vendim, aktivizohen të gjitha pagesat e shërbimeve shëndetësore si kanë qenë me herët.

znj. Ardita Rrahmani: Në rregulloren e taksave komunale janë të theksuara edhe kategoritë që lirohen nga pagesa.

z. Agim Mani: Jemi të vonuar në këtë drejtim, se pagesat e shërbimeve shëndetësore është dashur me u aktivizuar me përfundimin e pandemisë, sepse pandemia i ka 1 vit që ka përfunduar.

Kryesuesi i Kuvendit: Me rëndësi ka qenë në interes të qytetarëve, e jo në dëm të tyre.

z. Agim Mani: Dem nuk iu ka bërë qytetarëve, dhe ne jemi me vazhduar ende lirimin nga pagesa e shërbimeve shëndetësore, por nuk ka mundësi, ndërkaq çështja është se u punuar pa vendim.

znj. Ardita Rrahmani: Agim, unë dhe ti para dy mbledhjeve kemi diskutuar këtë çështje, por nganjëherë po i ndërrojmë fjalët tona, se bash unë edhe ti jemi ata që kemi kërkuar aktivizimin e shërbimeve shëndetësore.

z. Agim Mani: Je duke me keqkuptuar, unë kam thënë se vendimit i ka skaduar afati me mbylljen e pandemisë dhe jemi duke punuar pa vendim.

znj. Ardita Rrahmani: Debatin tani e kam personalisht me juve. Jam pikërisht unë që e kam gjetur edhe datën kur është shfuqizuar vendimi nga ministria e Shëndetësisë. Jam pikërisht unë para 3 muajve që kam biseduar me drejtorin e financave për me i kthyer pagesat në QKMF.

Keni qenë pikërisht ju i pajtimit që e keni aprovuar atë që e kam thënë unë. Unë nuk mundem me iu mësuar juve si grup se çka votoni, por çështja se para 2 muajve kemi kërkuar me ardhur ky vendim, sot ka ardhur edhe pse me vonesë, faji është i përbashkët i gjithë, nga drejtori, kryetari, kryesuesi dhe gjithë neve.

z. Agim Mani: Ju e keni mendimin e juaj.

znj. Ardita Rrahmani: Për atë që e kam mendimin tim, reagoval, se bashkë kemi reaguval.

z. Agim Mani: Ne kemi reaguval, se është e padrejtë të punohet pa një vendim. Tani vendimi ka ardhur, sidoqoftë vendimi mundet me u ndryshuar, e me u liruar nga taksat komunale qytetarët për shërbime shëndetësore.

znj. Ardita Rrahmani: Për cilat arsye?

z. Agim Mani: Për shumë arsye.

znj. Ardita Rrahmani: Ky debat kryesues, është në mes meje dhe Agimit. E zhvillova këtë debat, sepse po me thyhet inteligjenca si Ardite, e jo si anëtare e KPF apo si anëtare e LDK. Si doni shënoni në procesverbal, si doni jo, asgjë nuk me prishë punë mua.

Kryesuesi i Kuvendit: Vendimi është i bashkëngjitur lëndës dhe derisa nuk ndryshohet dhe plotësohet, vendimi është në fuqi.

znj. Ardita Rrahmani: Është e vërtetë se jemi vonuar në këtë drejtim.

Kryesuesi i Kuvendit: A është vonë apo herët, është vlerësimi i secilit, pajtohem që vendimi është pak me vonesë, Covid-19 ka edhe sot, por me vendim të ministrisë ka përfunduar zyrtarisht. Si do që të jetë, nuk kemi bërë asnjë dëm qytetarëve, ndërkaq për me mbetur vendimi ende në fuqi, duhen arsye.

znj. Ardita Rrahmani: Ne mundem me i liruar ende, por vendimi duhet të arsyetohet mbi çfarë baze me u liruar, se për dike ia vlen, për dike ndoshta e dëmtojmë me mbetur vendimi ende në fuqi.

Kryesuesi i Kuvendit: Kategoritë që kanë nevojë me u liruar, janë të liruar me rregulloren e taksave komunale, ata që nuk kanë nevojë, nuk ka nevojë me u liruar, se ata që kanë mundësi me i paguar taksat, pse mos me i paguar, se ka qytetarë që kërkojnë shërbime shëndetësore në spitale e ambulanca private.

znj. Ardita Rrahmani: Çështja është se shteti i Kosovës nuk ka sigurim shëndetësor. Ne çdo ditë ballafaqohemi me mjek, kërkojmë përgjegjësi prej tyre, ndërkaq ne nuk po japim asnjë cent për shëndetin tonë. Asnjë cent nuk paguajmë, kjo është shëndetësia primare, për me shkuar pastaj tutje, neve po na i shpëtojnë jetën, ndërkaq ne mos me paguar taksën 1 €. Nuk jam me jetua me lëmoshë, se nuk jam për lëmoshë.

z. Agim Mani: Unë e kam thënë që shëndetësia nuk ka mbledhë asnjë mjet për shërbime shëndetësore, së reagoval Ardita, por qytetarët me kanë thënë mua, që dikush nga ekzekutivi ka thënë që Agimi ka kërkuar me u funksionalizuar shërbimet shëndetësore.

znj. Ardita Rrahmani: Cilët qytetarë Agim, po të besoj, por nuk besoj se qytetarët e marrin e shikojnë procesin e KPF.

z. Agim Mani: E kemi diskutuar edhe në KK, unë kam kërkuar, nëse donë ta themi me emër çka kanë thënë qytetarit Agimi ka kërkuar që me u rikthye pagesat e shërbimeve shëndetësore dhe qytetari ta keqpërdorë mendimin, se kjo ndikon me tepër politikisht. Për atë unë tani po e themi të kundërtën.

znj. Ardita Rrahmani: Nuk është në rregull, nëse e ka thënë cilido nga ekzekutivi. Për me u liruar pagesat shëndetësorë edhe tutje Agim, duhet me pasur arsyetim.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne jemi institucion, ne jemi në shërbim të qytetarëve, nëse dikush e ka thënë se ne nuk jemi duke dashur, e ka gabim, por edhe me u marrë me debate të çarshisë si institucion, nuk ka kuptim. Ne ato mjete nuk kemi me i marrë për vete askush. Janë 33 mijë qytetarë, nëse dikush ta ka keqpërdorë prej ekzekutivit mendimin tuaj, pajtohem me juve, se ka gabuar shumë që e ka thënë, dhe mundesh me u ballafaqua me qytetarin dhe me zyrtarin e ekzekutivit që të ka thënë, e jo ky diskutim me u zhvillua në KPF.

znj. Ardita Rrahmani: Unë jam anëtare e KK gati që 3 vjet dhe kam qenë e kënaqur jashtëzakonisht shumë, edhe në KPF se ka ekzistuar një frymë e mirë, pavarësisht debateve, jemi në vit zgjedhor, secili mundohem me tërhequr diçka nga vetja, por jo me ndryshuar mendimin.

z. Agim Mani: Shumë me mirë është ju me dhënë mendimin e juaj e unë mendimin tim. Unë e di çka flas dhe si veproj.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF,

Aprovoj

Propozim Vendim për aktivizimin e pagesave në QKMF në Komunën e Kaçanikut. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Ivajë, në emër të Samedin Rexha;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtor, ka kohë që këto çështje po na kthehen nga ministria. A e keni njoftuar palën se nuk po kalojnë këto çështje në nivel qendror në mungesë të PZHK.

z. Qamil Stagova: Ne i kemi treguar, pala kërkon ndërrimin e destinimit për ndërtimin e një ferme, në emër të asaj që është veprimtari bujqësore. Jemi të vetëdijshëm për vendet e kësaj natyre që po i kthen ministria.

z. Agim Mani: Prona është e klasës 6, e lexova se pronari e ka për biznes, mirëpo në pjesën e njëjtë, afër kësaj prone, ministria e ka kthyer vendimin për ndërrim destinimi të njëjtit person Samedin Rexha për parcelën e njëjtë.

z. Qamil Stagova: Nuk me kujtohet nëse ka pasur me herët Samedin Rexha kërkesë për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

Kryesuesi i Kuvendit: Edhe mua nuk me kujtohet, varet çfarë ndërrimi destinimi ka kërkuar, se tani e ka për serë.

z. Agim Mani: Atëherë ka kërkuar ndërrimin e destinimit nga tokë bujqësore në ndërtimore, tani vetëm arsyetimi ka ndryshuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Po e provojmë edhe këtë herë këtë ndërrim destinimi, por u bë tepër, se po na i kthen ministria ndërrimin e destinimit. Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF e

Aprovoj

Propozim Vendimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, Zona Kadastrale Ivajë, në emër të Samedin Rexha. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

5. Propozim Vendim për shpallje me interes publik të Parcelave kadastrale në Zona Kadastrale Kaçanik dhe Gajre;

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo pikë është për shpallje me interes publik të pronës, e jo këmbim, ashtu si ka kërkuar ministria procedurat. Unë e pash se këtu figurojnë edhe parcelat e komunës me u shpallë interes publik. Parcelat e komunës nuk kanë arsyetim me u shpallë interes publik, ndërkaq e kuptoj se kanë me u këmbyer me pronën që shpallet me interes publik. Unë mendoj se duhet të shpallen me interes publik vetëm pronat e personave fizik që kanë qenë, ndërkaq të këmbimi duhet me u cekur.

z. Qamil Stagova: Ne kemi diskutuar këto çështje me zyrtarin juridik, ai me ka thënë se duhet të evidentohen edhe pronat komunale me i specifikuar të dy llojet e pronave që janë vlerë për këmbim. Unë në atë kuptim i kam specifikuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Po të kuptoj drejtor, por nuk ka logjikë toka e komunës me u shpallë me interes publik, mund të jam edhe gabim, se ndoshta ata i dinë me mirë këto çështje.

z. Agim Mani: Atë që e potencuat ju, këto janë përsëritë edhe ne vendimet tjera të mëhershme, që janë shqyrtuar 3-4 herë, njëjtë është edhe tani, pronat publike janë propozuar me u shpallë me interes publik. Unë e kam potencuar disa herë se nuk është e drejtë kjo, por përsëri është vepruar njëjtë. Nëse një pronë publike e shpallë me interes, cili është interesi, ku jeni bazuar? Këto është dashur me i cekur, ndërkaq kërkesën pala e ka bërë për këmbim të pronës.

z. Qamil Stagova: Interesi publik, hapin tjetër ne e kemi vlerësimin e këtyre pronave.

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtor, po dua me të plotësuar. Interesi publik i jonë është me i marrë pronat private. Në kuadër të atij interesi publik, komuna jep pronë në këmbim. Këto prona që i kemi, nuk janë me interes publik, se me qenë ne i shfrytëzojmë menjëherë. Prona që është e komunës janë publike, dhe nëse na duhen, bëhet vendimi, se nuk ka nevojë me u shpallë me interes publik, ndërkaq prona private është me interes publik të komunës, dhe për to mund të marrim vendim me i shpallë me interes publik, mandej vazhdojmë me procedurat për vlerësim të pronës dhe këmbim të pronës. Unë nuk jam jurist dhe nuk e di, por prona e komunës me u shpallë me interes publik, nuk është në rregull. E diskutojmë në KK.

z. Qamil Stagova: E analizojmë edhe njëherë këtë çështje dhe për KK e sqarojmë.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, e shtoj në votim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF e

Aprovoj

Propozim Vendim për shpallje me interes publik të Parcelave kadastrale në Zona Kadastrale Kaçanik dhe Gajre. Ky Propozim Vendim i Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

6. Propozim Vendim për Subvencionim të fermerëve;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika-Troni: Partecipimi prej 20% që paguajnë fermerët që përfitojnë nga subvencionet, a është e rregulluar në nivel lokal, apo është për krejt komunat njëjtë? Unë kam dëgjuar dhe kam ankesa nga fermerët se komunat tjera, fjala vjen Lipjani, nuk participojnë

fermerët me asnjë shumë të përqindjes. Nëse është ashtu, pse fermerët e komunës tonë participojnë?

z. Suhad Dullovi: Është në nivel komunal. Komuna jonë e ka një rregullore të subvencioneve dhe ndryshe është kur të participon fermeri, dhe nuk ka keqpërdorim të menaxhimit të pronës.

z. Agim Mani: Të pasuesi, mbështetja e fermerëve me freza 1.6m, për tërheqje me traktor, në vlerë 17,850,00 euro, kur e keni marrë këtë subvencion dhe a është përfunduar ky projekt?

z. Suhad Dullovi: Nuk është subvencion, është mbështetje e fermerëve direkt nga qeveria, projekti është në përfundim e sipër, për shkak se kompania që e ka fituar tenderin, nuk iu ka përmbajtur kushteve dhe ia kemi ndërprerë kontratën.

z. Agim Mani: Mjetet i keni, viti është mbyllë, a janë bartë mjetet?

z. Suhad Dullovi: Po, ndërkaq fermerët që kanë përfituar mbetën të njëjtë, përfituesit e fermerëve kanë paguar participimin 20% dhe nuk i obligojmë fermerët me participuar 2 herë. Tenderi është anuluar, ndërkaq mjetet janë shpenzuar në projektet tjera që i kemi pasur.

Kryesuesi i Kuvendit: Tani me duket se mjetet nuk barten, mbesin për ku janë planifikuar, pastaj alokohen.

z. Bahri Selimi: Vendimin e ka sjellë drejtori në harmoni me buxhetin e vitit 2024. Janë diku 5-6 mijë euro që bartën në bujqësi, mjete ka për realizimin e këtij projekti.

z. Agim Mani: Projekti, mbështetja e fermerëve me freza ka dalë në tender si e veçantë nga Zyra e prokurimit, është anuluar projekti

z. Suhad Dullovi: Kompania fituese nuk iu ka përmbajtur rregullave të tenderimit, dhe është anuluar projekti. Mjetet si shpenzim hynë në buxhetin e vitit 2024, ndërkaq fermerët janë ata që kanë përfituar në vitin e kaluar.

Kryesuesi i Kuvendit: A janë shpenzuar mjetet e vitit të kaluar, të parapara për këtë projekt? Të qartësohet kjo, se ky projekt realizohet me buxhetin e vitit 2024.

z. Suhad Dullovi: Mjetet janë shpenzuar. Unë e kam bërë një projekt në ministri, asnjë cent nuk e kam marrë.

z. Agim Mani: Cili është 20% e shumës së mjeteve që kanë participuar fermerët? Shuma 20% e participimit të fermerëve, bartet në vitin 2024, cili është shuma e 20% të këtij viti?

z. Suhad Dullovi: Nuk ka participim 20% të këtij viti. Lista e përfituesve janë ata që kanë përfituar në vitin 2023, ndërkaq lista e participimit të fermerëve 20% bartet sivjet.

znj. Kadrije Lika Troni: Lista po thuhet se është e vitit 2023 e përfituesve, unë mendoj se duhet me iu dhënë mundësi fermerëve me aplikuar edhe në vitin 2024.

z. Suhad Dullovi: Kemi projekte tjera që vazhdimisht i kemi mbështetur fermerët me të hyra direkt nga jashtë, e jo nga buxheti i komunës. Krejt duhet me lobuar në këtë drejtim, që me përfituar qytetarët e komunës së Kaçanikut, edhe ju Agim me lobuar në ministri të linjës.

z. Agim Mani: Nuk besoj se ka pasur asnjëherë mbështetje me të madhe se në qeverinë Kurti, subvencionet në bujqësi zakonisht janë rritur për fermerët.

z. Suhad Dullovi: Unë e kam bërë një projekt në shumë 150 mijë euro, por asnjë mjet qeveria nuk e ka ndarë për këtë projekt.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF

Aprovoj

Propozim Vendim për Subvencionim të fermerëve. Ky Propozim Vendim i Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

7. Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, të vitit 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Sipas këtij raporti, ishin zbatuar krejt rekomandimet e dhëna në raportin e auditimit. Nëse mundesh drejtor me na sqaruar qysh është zbatuar ky rekomandimi të e para, pagesa e avansit prej 10% e vlerës së kontratës për investime kapitale?

z. Bahri Selimi: Janë në shtylla veprimet e marra, ku kryetari dhe Zyra e prokurimit kanë marrë masa dhe pagesat për paradhënie .

z. Agim Mani: E pash në kolonë, por si ka pasur mundësi me zbatuar, me ia marrë ato mjete?

z. Bahri Selimi: Mjetet nuk janë kthyer.

Kryesuesi i Kuvendit: Edhe raporti i auditimit thotë që kryetari me marrë masa që këto çështje mos të ndodhin më. Masat janë marrë, kjo nuk ka ndodhë më, rekomandimi ka dalë i plotësuar.

z. Agim Mani: A ka ndodhë ndonjë rast i tillë në vitin 2023?

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk besoj.

z. Bahri Selimi: Nëse ndodhë në vitin 2023 ndonjë gjetje e tillë e auditorit, kjo e rritë rrezikun dhe na i prishë raportin.

z. Agim Mani: Të rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve, janë shtruar krejt rrugët. Pastaj është bërë projekti. Auditori ka thënë e keni shtruar rrugën pa projekt. Kjo është në vitin 2022, qysh ka pasur mundësi me u realizuar dhe pse keni vepruar njëjtë edhe në vitin 2023 të i njëjti projekt. Unë me tepër e kam për mendësinë e qeverisjes, e keni ndërtuar sallën në shkollën “Nazmi Osmani”, 350 mijë euro pa projekt.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk jemi duke folur për raportin e auditorit, por për zotimet që i ka dhënë komuna, se raporti është diskutuar me gjetjet. Këto janë zotimet që i ka marrë obligim komuna me i zbatuar. Raporti i auditorit të vitit 2023 ende nuk na ka ardhur.

Nënkryetari i Komunës: U përmend kontrata për subvencione në bujqësi, nuk e ka bërë me kontratë njëburimore, se me pa bërë nuk kishte ngelë asnjë cent.

z. Bahri Selimi: Kemi kontratë për hartim të projekteve, dhe kemi filluar në këtë drejtim, nuk i kryejmë punët pa pasur paramasë. për atë kemi pasur vlerësim nga auditori. Ajo është e kaluar, por duhet mos me ndodhë në vitet tjera mos me u përsëritë, se gabimet që ndodhin lënë gjurmë.

z. Sali Malsiu: Projekt është i vitit 2022, ai projekt ka kaluar.

z. Agim Mani: Projekti ka kaluar, edhe i sotmi kalon.

z. Sali Malsiu: Nuk e dimë e kalon, se ende nuk ka ardhur.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që kjo pikë të shkoj në KK për diskutim? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF **Diskutoj Raportin periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga**

Zyra Kombëtare e Auditimit, të vitit 2022. Ky raport periodik i përcjellët KK në procedurë për shqyrtim.

8. Raporti i punës i Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2023:

Kryesuesi i Kuvendit: Një raport i KPF është përgatitur nga zyrtarja e KK në pika të shkurtër. Nëse ka kush diçka, urdhëroni;

z. Agim Mani: Nuk e kam lexuar raportin, nëse ka mbetet diçka pa përfshirë, e diskutojmë në KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë konstatoj se KPF njëzëri u pajtuan që, **Raporti i punës i Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2023 t'i procedohet kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora: 11:47. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët.

Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 29.03.2024 në ora 11:00.

Procesmbajtëse
Makfire Malsiu

Kryesues i Kuvendit
Kemal Murseli



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo



Komuna e Kaçaniku

Opština Kaçanik - Municipal Kaçanik



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data: 17.04.24	Vendi: KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë
01	100/01	9155

RAPORTI TRE MUJOR FINANCIAR

Per periudhën: Janar – Mars

2024

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Për Kuvendin
Komunal

Kryetari i komunës :

Besim Ilazi



Kaçanik, Prill – 2024

I. Raporti i Buxhetit Komunal për periudhën Janar – Mars 2024:

Raporti i Buxhetit Komunal për periudhën Janar – Mars 2024 ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë. Ecuria e përgjithshme e këtyre treguesëve do të prezantohet për 12 (dymbëdhjetë) programet buxhetore:

1. Zyra e Kryetarit,
2. Administrata e Përgjithshme dhe Çështjet Gjinore,
3. Zyra e Kuvendit Komunal,
4. Buxhet dhe Financa,
5. Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm,
6. Shërbimet Publike, Mbrojtje Civile dhe Emergjencat,
7. Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural,
8. Planifikimi Urban dhe Mjedisi,
9. Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale,
10. Arsimit,
11. Kulturë, Rini dhe Sport,
12. Zyra Lokale për Komunitete.

RAPORTI I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN JANAR - MARS 2024

TABELA 1: IMPLEMENTIMI I BUXHETIT PËR PERIUDHËN JANAR - MARS 2023

TË HYRAT BUXHETORE		Buxheti i miratuar 2024	Buxheti i tanishëm 2024	Shpenzimet 31.03-2024	Shpenzimet 31.03-2023	Progresi në %	Krahasimi 2024/23 në €	Indeksi 2024/2023 (%)
		1	2	3	4	5=3/2	6=3-4	7=3/4
A	TOTAL FINANCIMI QEVERITAR	11,034,783.00	11,034,783.00	2,028,861.51	1,638,223.29	18.39	390,638.22	23.85
1	GRANTI I PËRGJITHSHËM	5,130,643.00	5,130,643.00	580,860.19	399,890.81	11.32	180,969.38	45.25
2	GRANTI I ARSIMIT	4,395,331.00	4,395,331.00	1,146,334.72	969,185.27	26.08	177,149.45	18.28
3	GRANTI I SHËNDETËSISË	1,508,809.00	1,508,809.00	301,666.60	269,147.21	19.99	32,519.39	12.08
8	TOTAL TE HYRAT VETANAKE-PARTICIPIMET DHE DONACIONET	924,200.00	924,200.00	908.80	-	0.10	908.80	#DIV/0!
4	TË HYRAT VETANAKE PROJEKSIONET 2024	924,200.00	924,200.00	908.80		0.10	908.80	#DIV/0!
5	TË HYRAT E BARTURA NGA VITI PARAPRAK	-	-	-		-	-	-
6	BARTJET E FONDEVE TË VITITER PARAPRAKE: DONATORËT, PARTICIPIMET	-	-	-	-			
TOTALI (A+B)		11,958,983.00	11,958,983.00	2,029,770.31	1,638,223.29	16.97	391,547.02	23.90

-Buxheti i përgjithshëm i planifikuar i Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2024, është caktuar sipas Qarkores Buxhetore nr.2024/01 me kufijtë buxhetor fillestar në shumë prej: **11,958,983.00€**.

- Burimet e financimit të Buxhetit Komunal vijnë nga:

1. Granti i përgjithshëm 5,130,643.00 €
2. Granti specifik i arsimit: 4,395,331.00 €
3. Granti specifik për shëndetësi: 1,508,809.00 € dhe
4. Të hyrat vetanake: 924,200.00 €

Struktura e përbërjes së buxhetit sipas burimeve të financimit duket kështu:

Grantet Qeveritare: 11,034,783.00 € apo 92.27 % e buxhetit total,
HVK – Projektionet : 924,200.00 € apo 7.73 % e buxhetit total.

-Shpenzimi total per periudhen Janar – Mars 2024 është në shumë prej 2,029,770.29€ apo 16.97% krahas planifikimit vjetorë.

II. Raporti i inkasimit të të hyrave vetanake:

Të hyrat vetanake **direkte** të grumbulluara gjatë periudhës raportuese kanë arritur lartësinë e realizimit prej **148,508.61 €** që përbëjnë **16.07%** të planifikimit të gjithëmbarshtëm vjetorë në shumë prej **924,200.00€**. Këto të hyra për periudhën Janar-Mars 2024 janë krijuar sipas burimeve të identifikuara nga të gjitha Drejtoritë bazuar në planifikimet vjetore.

- Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave janë grumbulluar gjithsej: **81,688.59€** apo **55%** e totalit të inkasimit nga të hyrat direkte komunale.
- Nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Kadastrit janë grumbulluar gjithsej mjete në shumë prej: **39,359.44€** apo **26.50%** e totalit të inkasimit nga të hyrat direkte komunale.
- Shuma tjetër e grumbullimit të mjeteve , është realizuar nga këto pesë (6) programe apo drejtori: Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, shuma prej: **2,513.42€**, Administratës së Përgjithshme, shuma prej: **4,724.00€**, Arsimit **11,798.00€**, Drejtoria e Bujqësisë, Plltarisë dhe Zhvillimit Rural, shuma prej: **2,636.91€**, Drejtoria e Shërbimeve Publike, shuma prej: **5,458.25€** dhe Zyra e Inspektoriatit shuma prej **330.00** që së bashku përbëjnë **18.50%** e totalit të inkasimit nga të hyrat direkte komunale.
- Krahasuar me inkasimin e realizuar të vitit 2023 të së njëjtës periudhë, nga raporti i realizimit të HVK-së të vitit 2024 del se janë inkasuar mjete prej: **21,143.00 €** më shumë se në vitin 2023 nga të hyrat direkte.

Të hyrat indirekte të cilat realizohen nga Gjykatat, Policia dhe Agjensioni Pyjor i Kosovës nuk na janë dërguar ende. Këto të hyra megjë realizohen nga këto institucione tjera, nuk përfshihen në planifikim por vetëm si realizim sepse edhe shpenzimi i tyre i takon komunave.

- Ndërsa tabela në vijim paraqet në mënyrë të përgjithshme realizimin e hvk-së për periudhën raportuese, krahasimin e realizimit mes drejtorive dhe viteve:

Emertimi i të hyrave vetanake	Planifikimi Janar-Dhjetor 2024	Realizimi: Janar Mars 2024	Plani/Realizimi vjetorë (në %)	Realizimi: Janar-Mars 2023	Krahasimi 2023/2022
Tatimi në pronë	391,545.00	44,659.71	11.41	48,760.08	(4,100.37)
Tatimi në tokë	80,543.00	19,139.88		20,870.35	(1,730.47)
Taksa nga rrethimi i automjeteve	70,000.00	16,460.00	23.51	14,805.00	1,655.00
Taksa nga ushtrimi i veprimtarisë	3,000.00	-	-	780.00	(780.00)
Taksa tjera	1,000.00	1,429.00	142.90	53.10	1,375.90
Total: Buxhet dhe Financa	546,088.00	81,688.59	14.96	85,268.53	(3,579.94)
Taksa komunale për leje ndërtimi	200,000.00	2,880.21	1.44	1,741.15	1,139.06
Taksa për regjistrimin e trashigimisë	2,000.00	840.00	42.00	-	840.00
Taksa tjera Administrative	1,000.00	13,642.00	1,364.20	11,217.50	2,424.50
Taksa për çerifikata të pronësisë dhe kopje plan	15,000.00	1,706.00	11.37	920.00	
Taksa për leje mjedisore	12,000.00	1,620.90	13.51	-	
Taksa për legalizimin e objekteve	10,000.00	5,683.23	-	3,381.88	
Shfrytëzimi i pronës publike	16,812.00	8,805.10	52.37	1,291.50	7,513.60
Taksa për matjen e tokës në teren	7,000.00	4,182.00	59.74	2,219.00	1,963.00
Total: Urbanizmi & Kadastr	263,812.00	39,359.44	14.92	20,771.03	13,880.16
Shfrytëzimi publik për tregti të hapur (reklamati)	1,600.00	4,769.25	298.08	908.80	3,860.45
Taksa për parking publik	10,000.00	689.00	6.89	550.00	
Taksa tjera Administrative	100.00	-	-	-	-
Total: Shërbimet Publike dhe Emergjencia	1,700.00	5,458.25	321.07	1,458.80	3,860.45
Taksa e Ndërrimit Destinimit të Tokës	20,000.00	2,136.50	10.68	6,427.25	(4,290.75)
Taksa për Shfrytëz. e Resurseve nat.	2,000.00	-	-	-	-
Taksa tjera	2,000.00	500.41	25.02	-	500.41
Total: Bujqësia dhe Pylltaria	24,000.00	2,636.91	10.99	6,427.25	(3,790.34)
Taksa e çertifikatave të lindjes	15,000.00	3,628.00	24.19	-	3,628.00
Taksa e çertifikatave të kurorëzimit	5,000.00	532.00	10.64	-	532.00
Taksa e çertifikatave të vdekjes	1,000.00	100.00	10.00	-	100.00
Taksa e çertifikatave tjera ofiçare	5,000.00	427.00	8.54	80.00	347.00
Taksa tjera Administrative	1,000.00	37.00	3.70	-	37.00
Total: Administrata e Përgjithëshme	27,000.00	4,724.00	17.50	80.00	4,644.00
Gjobat nga inspektorati	5,000.00	330.00	6.60	1,269.00	(939.00)
Inspektimi higjieniko-sanitarë	200.00	-	-	-	-
Inspektimi i respektimit të planit Urb.	200.00	-	-	-	-
Licencat pranimit tekn. lokalit	200.00	-	-	-	-
Total: Të hyrat nga Inspektorati	5,600.00	330.00		1,269.00	(939.00)
Taksa për çertifikata mjekësore	10,000.00	2,513.42	25.13	2,925.00	(411.58)
Participimet në shëndetësi	10,000.00	-	-	-	-
Total: Shëndetësia dhe M.S.	20,000.00	2,513.42	12.57	2,925.00	(411.58)
Participimet	36,000.00	11,798.00	32.77	9,166.00	2,632.00
Total: Arsimit dhe Kultura	36,000.00	11,798.00	32.77	9,166.00	2,632.00
GJITHSEJ TË HYRAT DIREKTE	924,200.00	148,508.61	16.07	127,365.61	21,143.00
Të hyrat nga gjobat e gjykatave	-	-	-	1,720.00	(1,720.00)
Të hyrat nga gjobat e trafikut	-	-	-	44,532.00	(44,532.00)
Të hyrat nga APK (Pylltaria)	-	-	-	-	-
TË HYRAT INDIREKTE	-	-		46,252.00	(46,252.00)
TOTALI I TË HYRAVE VETANAKE	924,200.00	148,508.61	16.07	173,617.61	(25,109.00)

III . Shpenzimet e realizuara për periudhën Janar – Mars 2024:

Dinamika e shpenzimeve për këtë periudhë është realizuar me **16.97 %** në raport me Buxhetin Fillestar të miratuar apo shuma prej **2,029,770.31€** ndërsa krahasuar më periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi shkallën e shpenzimit prej **23.90%** më shumë apo shumën prej: **391,547.00€**.

KATEGORITE EKONOMIKE TË SHPENZIMEVE (KESH)		Buxheti aktual 2024	Shpenzimet e realizuara 31.03-2024	Shpenzimet e realizuara 31.03-2023	Progresi përball plan. buxhetor	Krahasimi: Buxheti - Shpenzimet	Krahasimi 2023 / 2022 në €	Krahasimi 2023/2022 në %
		1	2	3	4=2/1	5=1-2	6=2-3	7=2/3
1	Pagat dhe medijtjet	6,759,180.00	1,656,368.42	1,443,931.17	24.51	5,102,811.58	212,437.25	14.71
2	Mallrat dhe shërbimet	1,421,513.00	235,941.69	158,090.86	16.60	1,185,571.31	77,850.83	49.24
3	Shpenzimet komunale	200,000.00	34,135.00	14,021.26	17.07	165,865.00	20,113.74	143.45
4	Subvencionet dhe transferet	415,529.00	21,689.00	14,682.00	5.22	393,840.00	7,007.00	47.73
5	Shpenzimet kapitale	3,137,761.00	81,636.20	7,498.00	2.60	3,056,124.80	74,138.20	988.77
6	Rezerva komunale	25,000.00	-	-	-	25,000.00	-	
TOTALI (1 deri 6)		11,958,983.00	2,029,770.31	1,638,223.29	16.97	9,929,212.69	391,547	23.90

Tabela e planifikimit të ndarjeve buxhetore sipas Drejtorive apo Programeve Buxhetore për vitin 2024:

SEKTORI - DREJTORIA:	PAGA DHE MEDITJE	MALLRA DHE SHERBIME	SHPENZIME KOMUNALE	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	INVESTIME KAPITALE	TOTALI
ZYRA E KRYETARIT	247,733.53	20,000.00	-	60,000.00	-	327,733.53
ADMINISTRATA E PERGJITHSHME & Q.Gjinore	154,956.21	85,000.00	15,000.00	-	412,000.00	666,956.21
KUVENDI KOMUNAL	221,755.26	5,000.00	-	-	-	226,755.26
ZHVILLIMI EKONOMIK	23,954.42	5,000.00	-	40,000.00	335,000.00	403,954.42
BUXHETIMI - FINANCAT	80,601.27	10,000.00	-	-	250,000.00	340,601.27
SH.PUBLIKE, MBROJTJA CIVILE DHE EMERGJENCA	245,600.91	310,000.00	80,000.00	60,000.00	496,313.00	1,191,913.91
ZYRA E KOMUNITETEVE	10,439.86	1,000.00	-	-	-	11,439.86
BUJQESIA, PYLLTARIA DHE ZHVILLIMI RURAL	104,111.60	10,000.00	-	100,000.00	50,000.00	264,111.60
URBANIZMI - PLANIFIKIMI URBAN	116,206.76	65,000.00	-	-	1,012,279.00	1,193,485.76
AD.SHËND. DHE SHERBIMET SOCIALE	88,225.95	5,000.00	5,000.00	10,000.00	5,000.00	113,225.95
SHERBIMET SHENDETESORE PRIMARE	1,138,296.07	290,513.00	50,000.00	-	50,000.00	1,528,809.07
KULTURA, RINIA, SPORTET	131,628.93	130,000.00	15,000.00	70,000.00	135,000.00	481,628.93
ARSIMI DHE SHKENCA	4,208,367.24	385,000.00	50,000.00	50,000.00	515,000.00	5,208,367.24
TOTAL BUXHETI:	6,771,878.00	1,321,513.00	215,000.00	390,000.00	3,260,592.00	11,958,983.00

Tabela në vijim paraqet shpenzimin sipas Programeve Buxhetore dhe atë sipas K.Ekonomike Janar-Mars 2024:

NR	PROGRAMET BUXHETORE (11)	Stafi i lejuar	Pagat dhe mëditje	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Totali	Struktura në % sipas (PB)
1	Zyra e kryetarit	27	61,631.28	15,794.95		1,000.00		78,426.23	3.86
2	Administrata e pergjithshme	25	39,914.22	22,959.33	3,496.98			66,370.53	3.27
3	Zyra e kuvendit komunal	23	56,223.95	451.90				56,675.85	2.79
4	Financat, Buxheti	11	16,066.68					16,066.68	0.79
5	Zhvillimi Ekonomik, Turizmi	3	4,523.46	456.90			15,000.00	19,980.36	
6	Sherbimet publike dhe emergjenca	28	86,610.63	130,995.02	15,101.21	7,000.00	16,636.20	256,343.06	12.63
7	ZLK	1	2,720.61					2,720.61	-
8	Bujqesia, Pylltaria dhe ZHR	15	13,990.51	1,539.91				15,530.42	0.77
9	Kultura, Rinia dhe Sportet	18	28,680.51	10,855.30	5,566.05			45,101.86	
10	Planifikim urban dhe mjedisi	13	24,615.23	98.16				24,713.39	1.22
	ADMINISTRATA KOMUNALE	164	334,977.08	183,151	24,164	8,000	31,636	516,846.77	25.46
11	Shendetesia dhe mireqenia soc.	130	273,611.88	23,563.97	3,990.75	500.00		301,666.60	14.86
12	Arsimi	535	1,047,779.46	29,226.25	5,980.01	13,189.00	50,000.00	1,146,174.72	56.47
	TOTALI (1 deri 11)	829	1,656,368.42	235,941.69	34,135.00	21,689.00	81,636.20	2,029,770.31	100.00
	Struktura ne % sipas (KESH)		81.60	11.62	1.68	1.07	4.02	100.00	

KESH	MALLËRAT DHE SHËRBIMET	PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE NË MALLËRA DHE SHËRBIME										Sipas gjendjes më 31.03.2024			TM1 2023	Dallimi ne EURO	
		Zyra e Kryetarit	Zyra e Kuvendit	Administrata e Përgjithshme	Financa & Zhv. Ekonomik	Sherbimet Publike	Bujqësia, Pylltaria dhe ZHR	Urbanizimi dhe Kadastr	Kultura, rinia dhe sporti	Arsimi dhe Shkenca	Shëndetësia dhe MS	Totali TM1/2024	Struktura në %				
13140	UDHËTIMET ZYRTARE JASHT VENDIT	7,350.00													7,350.00	3.12	7,350
13310	SHPENZIMET E INTERNETIT						20.16								20.16	0.01	(420)
13360	SHPENZIMET E TELEFONISË MOBILE			467.00											467.00	0.20	-
13330	SHPENZIMET POSTARE			14.40											14.40	0.01	(4,010)
13410	SHPENZIMET E ARSIMIT E TRAJNIMIT														-	-	-
13420	SH.E PËRFAQËSIMIT DHE AVOKATURËS														-	-	-
13430	SHËRBIMET E NDRYSHIME SHËNDETËSORE													1,970.00	1,970.00	0.83	-
13440	SHËRBIMET E NDRYSHIME Intelektuale-këshilldhënë	510.40		6,350.40										1,750.00	8,610.80	3.65	7,741
13470	SHPENZIMET E SHËRBIMEVE TEKNIKE	1,010.00			70.00	100.00								545.00	1,725.00	0.73	(481)
13460	SHPENZIMET E SHËRBIMEVE KONTRAKTUESE													990.00	990.00	0.42	(30,069)
13475	SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE PUBLIKE			3,506.56										876.64	4,383.20	-	15,780
13480	SHPENZIMET PËR ANËTARSIM	5,011.35												3,460.00	5,011.35	2.12	4,011
13501	MOBILIJE (më pak se 1000 euro)														3,460.00	1.47	3,460
13556	SHPENZIMET E PAISJES SPECIALE MJEKËSORE														-	-	(3,776)
13610	SHPENZIMET E FURNIZIMIT PËR ZYRË	124.80												100.00	1,204.80	0.51	(2,163)
13620	SHPENZIMET E FURNIZIMIT ME USHQIM E PIJE	90.10		1,164.10										2,530.79	3,959.10	1.68	(265)
13630	SHPENZIMET E FURNIZIMEVE MJEKËSORE														-	-	(9,116)
13640	SHPENZIMET E FURNIZIMEVE HIGJENIKE			200.00											200.00	0.08	200
13720	SHPENZIMET E NAFTËS PËR NGROHJE														-	-	(743)
13760	DRUTË DHE PRODHIMET E DRURIT PËR NGROHJE			319.40											24,274.40	10.29	21,176
13780	DERVATET PËR AUTOMJETE DHE G.JENERATOR			2,050.33		1,037.78								87.32	4,260.18	4.79	(1,056)
